

# Hulumtim

MUNGESA E EDUKIMIT MEDIAL  
NË KOSOVË



Hulumtuese:

**Dr.sc. Ilire Zajmi – Rugova dhe Elza Islami**

# HYRJE:

Kosova aktualisht ka një nivel depërtimi të internetit prej **96%**, mbi **40** televizione kombëtare dhe lokale si dhe numër të madh të medieve online në gjuhën shqipe. Këto të dhëna tregojnë se qytetarët e Kosovës janë të ekspozuar në masë të madhe në media dhe në informacion. Dobitë nga qasja e lirë në një gamë të gjerë të informacionit nënkuptojnë edhe përgjegjësinë e konsumimit të këtij informacioni në mënyrë kritike.

Për ta bërë këtë, një individ duhet të jetë në gjendje t'i kuptojë funksionet e medieve dhe ofruesve të tjerë të informacionit, ta vlerësojë në mënyrë kritike përmbajtjen e tyre dhe të marrë vendime të informuara si përdorues dhe prodhues i informacionit dhe përmbajtjes së medias.

Edukimi mbi Media dhe Informacionin (**EMI**) kuptohet sipas konceptit të **UNESCO-s** për funksionet e medieve dhe burimeve të informacionit në shoqëritë liberale demokratike. EMI është një koncept i ndërlikuar dhe shumë-shtresor që mbulon njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet e qytetarëve individualë, për ta shfrytëzuar medien dhe burimet e informacionit në një mënyrë të arsyeshme dhe etike, jo vetëm në aspektin e funksionit, por si një kompetencë e të mësuarit gjatë gjithë jetës.

Ai ka të bëjë me nivelin e edukimit të qytetarëve ndaj informacionit, teknologjisë dhe medias, për të kuptuar burimet e informacionit, si dhe për procesin, interpretimin dhe përdorimin e duhur dhe etik të këtyre informatave.

Si i tillë, **EMI** është i lidhur ngushtë me politikën e arsimit, mediet dhe lirinë e informimit, si dhe politikën e qasjes në informata.

Sa i përket përfshirjes së EMI në edukimin formal, institucioni përgjegjës për rregullimin e politikave të arsimit në Kosovë, Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (**MASHT**), ka bërë disa përpjekje e iniciativa.

Në anën tjetër, organizatat ndërkombëtare dhe lokale si dhe shoqëria civile kanë realizuar projekte të shumta dhe kanë ndërmarrë iniciativa të ndryshme për të çuar më tutje një qasje të Edukimit mbi Medien dhe Informacionin në arsimin formal dhe joformal.

Me organizatat ndërkombëtare, siç është **OSBE, UNICEF, USAID, OKB, GIZ, NDI, Hibrid**, dhe të tjerat duke e vënë fokusin në trajnimin e stafit arsimor të shkollave, ndërsa iniciativa të tjera bazë përqendrohen në zhvillimin e shkathtësive kritike të leximit dhe të interpretimit.

Këto iniciativa dhe përpjekje janë tregues i qartë se Kosova ka nevojë të angazhohet në zhvillimin dhe zbatimin e një strategjie për EMI që harmonizon të gjitha politikat nacionale në arsimin formal, dhe atë joformal, mediet si dhe shoqërinë civile dhe sektorin privat.

Me gjithë përfshirjen e hisedarëve përgjegjës si Ministria e Arsimit Teknologjisë e Shkencës (**MASHT**), Universiteti i Prishtinës, Zyra e Kryeministrit, Komisioni i Pavarur për Media, shoqëria civile, organizatat ndërkombëtare e lokale, shtrohet pyetja a ka mungesë të Edukimit mbi Medien dhe Informacionin në Kosovë?

Pikërisht kjo çështje trajtohet në këtë hulumtim, i cili synon të japë një pasqyrë të qartë të situatës në këtë rrafsh.



Hulumtimi fokusohet te aktivitetet që trajtojnë temat e edukimit medial, nivelin e njohurive dhe qëndrimeve në lidhje me mediet dhe zhvillimin e mendimit kritik, ndikimin dhe përdorimin e teknologjisë dhe rrjeteve sociale në aktivitetet e organizatave rinore, rrezikun e ekspozimit ndaj dezinformimit e lajmeve të rreme si dhe ofrimin e trajnimeve dhe burimeve specifike për të mbështetur punën me të rinjtë. Ai ofron rezultate, të cilat na tregojnë se si mund të ndikohet në rritjen e ndërgjegjësimit për Edukimin mbi Medien dhe Informacionin në Kosovë, rreziqet dhe pasojat e mungesës së tij si dhe domosdoshmërinë e futjes së kësaj lënde në kurrikulën bërthamë të sistemit arsimor të Kosovës.

Qëllimi i hulumtimit është të vlerësojë nivelin dhe efektivitetin e Edukimit mbi Medien dhe Informacionin e të rinjve në Kosovë dhe të identifikojë faktorët që ndikojnë në perceptimin dhe përdorimin e medieve si burim informacioni me theks të zhvillimit të mendimit kritik ndaj tyre.

Rezultatet e hulumtimit kanë nxjerrë në pah një interes të lartë dhe një angazhim aktiv të rinjve në Kosovë për Edukimin mbi Medien dhe Informacionin. Është e qartë se të rinjtë vlerësojnë dhe përdorin burime të ndryshme të informacionit, duke përfshirë rrjetet sociale dhe portalet online, për të qëndruar të informuar dhe kritikë ndaj lajmeve që konsumojnë. Rezultatet tregojnë se edukimi medial është thelbësor për të ndihmuar të rinjtë të identifikojnë dhe të luftojnë dezinformimin e lajmet e rreme, si dhe si të zhvillojnë aftësi kritike të mendimit.

# METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Për të sjell një pasqyrë sa më të plotë të perceptimeve të rinjve mbi mënyrën se si ata i qasen informacionit, përdorin teknologjinë si dhe njohuritë rreth Edukimit mbi Medien dhe Informacionin, për nevoja të këtij hulumtimi janë përdorur metoda të kombinuara hulumtuese.

Intervistat primare online janë zhvilluar me individë kyç dhe ekspertë të njohur në fushën e Edukimit mbi Medien dhe informacionin në Kosovë. Ekspertë nga Ministria e Arsimit Shkencës e Teknologjisë (**MASHT**), Këshilli i Medieve të Shkruara të Kosovës (**KMSHK**), Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” (**UP**) Universiteti për Biznes dhe Teknologji (**UBT**), si dhe nga njëra ndër organizatat e cila ka mbështetur projekte e iniciativa të panumërta për EMI, Organizata për Bashkëpunim e Siguri në Evropë (**OSBE**) janë intervistuar për të dhënë vlerësimet rreth mungesës së edukimit medial në Kosovë, pasojat dhe rreziqet e mungesës së tij për të rinjtë; pastaj arsyet pse kjo lëndë duhet të mësohet në shkolla, si dhe harmonizimit të kornizës aktuale të arsimit me fokus në të menduarit kritik dhe përfshirjen e **EMI** në kurrikulën e sistemit arsimor të Kosovës.

Intervistat me shkrim janë zhvilluar me pesë punëtorë të organizatave të rinjve. Intervista është hartuar me 15 pyetje të detajuara, të cilave punëtorët rinorë u janë përgjigjur në formë të shkruar. Pyetjet janë përpiluar për të matur nivelin e angazhimit, njohurive dhe qasjes ndaj Edukimit mbi Medien dhe Informacionin në mesin e të rinjve në Kosovë.

Gjithashtu, për nevoja të hulumtimit, është përdorur metoda e anketës, e zhvilluar me të rinj që veprojnë në lokalitete të ndryshme të Kosovës.

Anketa përfshin një mostër prej **60** të anketuarve, të ndarë në **27** meshkuj dhe **33** femra. Të anketuarit vijnë nga disa rajone të ndryshme të Kosovës, përfshirë Prishtinën, Fushë Kosovën, Gjilanin, Gjakovën, Istogun, Mitrovicën, Pejën, Podujevën, Skenderajn, Obiliqin e Maxhunaj.

Mosha e pjesëmarrësve të anketuar sillet nga **15** deri në **36** vjeç. Niveli i arsimimit të anketuarve ndahet në **44** me arsim universitar si dhe 16 me arsim të mesëm.

# REZULTATET E HULUMTIMIT


## 1. Qasja në informacion, preferencat dhe perceptimet

Hartimi i pyetësorit të anketës, është bërë duke u fokusuar në çështjet thelbësore të cilat i trajton hulumtimi e që kanë të bëjnë me konsumin dhe burimet e informacionit, kuptimin e dezinformimit e lajmeve të rreme, futjen e lëndës së Edukimit mbi Medien dhe Informacionin në kurrikulat arsimore, mungesën e edukimit medial si dhe aktivitetet që rrisin ndërgjegjësimin për kultivimin e mendimit kritik te organizatat e të rinjve. Pyetësori është i përpiluar me shtatë pyetje e nën pyetje.



### 1. Sa shpesh i lexoni lajmet në ditë? A mendoni se është e rëndësishme të jeni të informuar për ngjarjet e fundit?

Shumica e të anketuarve pohojnë se lexojnë lajme rregullisht. Përgjigjet lëvizin nga "një herë në ditë" deri në "vazhdimisht gjatë gjithë ditës". Shtresa më aktive e të anketuarve përgjigjet se lexon lajme 2-3 herë në ditë ose më shumë. Disa të anketuar preferojnë të informohen përmes medieve sociale dhe nuk i ndjekin aktivisht lajmet përmes burimeve tradicionale. Pothuajse të gjithë të anketuarit e konsiderojnë të rëndësishme të jenë të informuar për ngjarjet aktuale. Arsyet e theksuara përfshijnë nevojën për të qenë të sigurt, të vetëdijshëm për çështjet e rëndësishme dhe pjesëmarrje aktive në realitetin shoqëror. Megjithatë, disa të anketuar shprehin ndjenjën e mbingopjes nga lajmet ose preferojnë të marrin informacion vetëm për çështje që i preokupojnë direkt.



**Figura 1. Frekuenca e leximit të lajmeve**

Diagrami në figurën 1 tregon sa shpesh të anketuarit lexojnë lajmet. Siç mund të shihet, shumica e të anketuarve lexojnë lajme disa herë në ditë, duke treguar një angazhim të lartë me lajmet rregullisht. Ky model i leximit mund të ndikojë në perceptimet dhe sjelljet e tyre ndaj informacionit dhe medieve.


## **2. Cilat janë dy burimet kryesore të informacionit për ju? Përse preferoni ato burime?**

Në vlerësimin e burimeve kryesore të informacionit për 60 të anketuar lidhur me mënyrën si ata qasen në lajme dhe përse preferojnë burime specifike të informacionit, rezultatet përfshijnë një gamë të gjerë preferencash dhe arsyesh.

Sa i përket burimeve të informacionit, shumë të anketuar janë përgjigjur se përdorin rrjetet sociale si Facebook, Instagram dhe Twitter si burime kryesore të marrjes së informacionit, duke theksuar lehtësinë dhe shpejtësinë e qasjes në informacion. Platformat si YouTube dhe Reddit gjithashtu janë të preferuara për lajmet specifike ose tematike.

Portalet e lajmeve si **Telegrafi**, **Koha.net**, dhe **Gazeta Express** janë dalluar për seriozitetin dhe besueshmërinë e informacionit. Këto portale përmenden për raportimin e saktë dhe të përditësuar.

Televizionet dhe gazetatat në formë elektronike mbeten burime të rëndësishme për disa përdorues, të cilët vlerësojnë përmbajtjen e tyre të saktë dhe të drejtpërdrejtë. **19** persona kanë përmendur përdorimin e internetit dhe rrjeteve sociale si burime kryesore të informacionit. **16** persona kanë përmendur përdorimin e portaleve online si burime kryesore të informacionit. Ndërsa **18** persona kanë përmendur përdorimin e medieve tradicionale si burime kryesore të informacionit.



**Figura 2. Burimet e Informacionit**

### Arsyet e Preferencës

Shumica e të anketuarve përmendin se preferojnë burimet e tyre për shkak të qasjes së lehtë dhe të shpejtë në informacion. Burimet online si portalet dhe rrjetet sociale u mundësojnë atyre të qëndrojnë të informuar në mënyrë të vazhdueshme.

Mjetet e teknologjisë moderne, si telefonat e mençur dhe kompjuterët, u mundësojnë atyre të konsumojnë lajme në mënyrë të përshtatshme, kudo dhe kurdo.

Disa të anketuar theksojnë rëndësinë e burimeve që ofrojnë informacion të saktë dhe të besueshëm, veçanërisht në kohën kur dezinformimi mund të jetë i përhapur.

Disa të tjerë, si ata në fusha të caktuara profesionale, preferojnë burime që ofrojnë lajme të detajuara ose specifike për fushën e tyre.


### 3. A mund ta përshkruani me fjalët tuaja se çka kuptoni me dezinformim?

Sipas përgjigjeve të dhëna, shumica e të anketuarve e kuptojnë dezinformimin si një proces të shpërndarjes së informacioneve të rreme, të pasakta, ose të manipuluar me qëllim. Këto përgjigje përfshijnë të dhëna që përshkruajnë dezinformimin në mënyra të ndryshme, duke theksuar konceptet e mashtrimit, manipulimit, dhe keqinformimit.

Kategoritë kyçe të përmendura në përgjigjet e të anketuarve janë; informacione të rreme ose të pasakta, manipulimi ose mashtrimi dhe shpërndarje e qëllimshme e informacionit të gabuar.

### 4. A zhvilloni ndonjëherë diskutime ose aktivitete që trajtojnë temat e edukimit medial në organizatën ku jeni vullnetar/e?

Bazuar në përgjigjet e dhëna për zhvillimin e diskutimeve ose aktiviteteve që trajtojnë temat e edukimit medial në organizatat ku pjesëmarrësit janë vullnetarë, janë analizuar përgjigjet me "Po" dhe "Jo" për të kuptuar më mirë angazhimin e tyre. Nga përgjigjet e dhëna, rezulton se 17 të anketuar kanë thënë se zhvillojnë diskutime ose aktivitete që trajtojnë temat e edukimit medial në organizatat ku janë vullnetarë. Kjo përfshin edhe përgjigje që theksojnë se ndodh "nganjëherë" ose "rrallë". 11 të anketuar kanë thënë se nuk zhvillojnë ose nuk janë pjesë e aktiviteteve të tilla.



**Figura 3. Angazhimi i të rinjve në Aktivitetet e Edukimit Medial**

Te figura 3, ilustrohet pjesëmarrja e të anketuarve në aktivitete të edukimit medial në organizatat ku ata janë vullnetarë. Nga diagrami, shihet se një numër më i madh i të anketuarve ose në shifra 17 kundrejt 11, janë angazhuar në aktivitete të tilla, që tregojnë një interes të lartë për edukimin medial.

Kjo tregon për një angazhim relativisht të lartë në aktivitetet e lidhura me edukimin medial në mesin e atyre që janë pjesë e organizatave të ndryshme, duke reflektuar një përqendrim në rritjen e ndërgjegjësimit dhe trajnimit për menaxhimin e informacionit dhe medieve.



## 5. Si ndikon përdorimi i teknologjisë dhe rrjeteve sociale në punën tuaj vullnetare?

Duke u bazuar në përgjigjet e dhëna rreth ndikimit të përdorimit të teknologjisë dhe rrjeteve sociale në punën vullnetare, shumica e të anketuarve e shohin këtë ndikim si pozitiv. Ata theksojnë se teknologjia dhe rrjetet sociale ndihmojnë në promovimin e aktiviteteve, shpërndarjen e informacionit, dhe lehtësimin e komunikimit. Megjithatë, në disa përgjigje gjithashtu përmenden aspektet negative siç janë dezinformimi dhe menaxhimi i kohës në rrjete sociale.

## 6. A duhet të futet edukimi medial si lëndë obligative në shkolla, në mbështetjen e të rinjve për të qenë më të ndërgjegjshëm dhe kritikë ndaj medieve dhe informacionit?

Analiza e përgjigjeve për pyetjen nëse edukimi medial duhet të futet si lëndë obligative në shkolla tregon një mbështetje të konsiderueshme për përfshirjen e tij në arsimin formal. Shumica e pjesëmarrësve shprehen pozitivisht për rëndësinë e edukimit medial për të rinjtë, duke e parë atë si një mjet kyç për të rritur ndërgjegjësimin dhe kritikën ndaj mediave dhe informacionit.

Shumica e pjesëmarrësve mbështesin idenë që edukimi medial të bëhet lëndë obligative, ndërsa një numër më i vogël preferon që të jetë zgjedhore ose janë neutralë. Kjo reflekton një mbështetje të qartë për rëndësinë e edukimit medial në formimin e qytetarëve të informuar dhe kritikë.

Qëndrimet mbi edukimin medial si lëndë obligative në shkolla




Figura 4. Edukimi medial, lëndë obligative në shkolla

Kjo reflekton një mbështetje të qartë për rëndësinë e edukimit medial në formimin e qytetarëve të informuar dhe kritikë.

Të anketuarit janë ndarë midis atyre që mendojnë se kjo lëndë duhet të jetë obligative dhe atyre që sugjerojnë që ajo të jetë zgjedhore. Argumentet pro lëndës obligative theksojnë nevojën për të siguruar që të gjithë nxënësit të fitojnë aftësitë e nevojshme për të kërkuar dhe analizuar informacionin në një botë gjithnjë e më të mbushur me media.

Ata theksojnë se kjo është veçanërisht e rëndësishme për shkak të rritjes së dezinformimit dhe informacionit të rremë që mund të ndikojnë negativisht në shoqëri.

Nga ana tjetër, ata që preferojnë që edukimi medial të jetë lëndë zgjedhore argumentojnë që kjo mund të lejojë më shumë fleksibilitet dhe të përshtatet më mirë me interesat dhe nevojat e nxënësve. Disa të anketuar sugjerojnë që edukimi medial mund të integrohet si një kapitull brenda lëndëve ekzistuese ose të ofrohet përmes moduleve ose trajnimeve të veçanta, duke ruajtur një qasje më fleksibile.

Përmbledhja e përgjigjeve të dhëna, tregon një konsensus të qartë për rëndësinë e edukimit medial, megjithëse ka një debat të vazhdueshëm nëse duhet të jetë pjesë obligative e kurrikulës apo jo. Ky debat pasqyron sfidat dhe mundësitë që paraqiten në përgatitjen e të rinjve për të qenë konsumatorë të përgjegjshëm dhe kritikë të mediave në një epokë digjitale.

## **7. A keni ndonjë sugjerim për organizatat jo-qeveritare për të përmbushur më mirë rolin e tyre në edukimin medial të komunitetit?**

Nëse shqyrtohen përgjigjet e dhëna nga të anketuarit rreth sugjerimeve për organizatat jo-qeveritare për të përmbushur më mirë rolin e tyre në edukimin medial të komunitetit, vërehet një konsensus i fortë rreth nevojës për të rritur përpjekjet dhe përmirësuar qasjet.

Shumica e të anketuarve sugjerojnë që organizatat duhet të organizojnë trajnime të drejtpërdrejta dhe intensive që janë të drejtuara nga profesionistë në fushën e medias dhe edukimit medial. Pjesëmarrësit theksojnë rëndësinë e përdorimit të rrjeteve sociale për të përhapur informacionin në mënyrë efikase, duke përmendur gjithashtu nevojën për të adresuar dhe luftuar dezinformimin nëpërmjet verifikimit të fakteve.

Një tjetër pikë që pjesëmarrësit e shohin si thelbësore është që organizatat të angazhohen në fushata dhe aktivitete të ndryshme informuese që përfshijnë të gjitha grupmoshat, duke përfshirë edhe të moshuarit, në mënyrë që të zgjerojnë ndikimin e tyre edukativ në të gjithë spektrin demografik. Këto aktivitete duhet të jenë jo vetëm informuese, por edhe atraktive dhe të angazhuara për të mbajtur në nivel interesin e publikut.

Gjithashtu, përmendet nevoja për një bashkëpunim më të ngushtë me institucionet arsimore, si shkollat dhe universitetet, për të integruar edukimin media në mënyrë më të qëndrueshme në sistemin arsimor. Kjo do të ndihmonte në krijimin e një baze të qëndrueshme dhe të gjerë të njohurive për mediet, nga e cila do të përfitonin nxënësit që në moshë të re.

Në përgjithësi, rekomandohet që organizatat jo-qeveritare të jenë më aktive dhe kreative në përdorimin e teknologjisë dhe të zhvillojnë materiale edukative që janë të lehta për t'u kuptuar dhe të qasshme për një audiencë të gjerë, me qëllim përmirësimin e ndërgjegjësimit dhe mendimit kritik në komunitet.

Një tjetër pikë që pjesëmarrësit e shohin si thelbësore është që organizatat të angazhohen në fushata dhe aktivitete të ndryshme informuese që përfshijnë të gjitha grupmoshat, duke përfshirë edhe të moshuarit, në mënyrë që të zgjerojnë ndikimin e tyre edukativ në të gjithë spektrin demografik. Këto aktivitete duhet të jenë jo vetëm informuese, por edhe atraktive dhe të angazhuara për të mbajtur në nivel interesin e publikut.

Gjithashtu, përmendet nevoja për një bashkëpunim më të ngushtë me institucionet arsimore, si shkollat dhe universitetet, për të integruar edukimin media në mënyrë më të qëndrueshme në sistemin arsimor. Kjo do të ndihmonte në krijimin e një baze të qëndrueshme dhe të gjerë të njohurive për mediet, nga e cila do të përfitonin nxënësit që në moshë të re.

Në përgjithësi, rekomandohet që organizatat jo-qeveritare të jenë më aktive dhe kreative në përdorimin e teknologjisë dhe të zhvillojnë materiale edukative që janë të lehta për t'u kuptuar dhe të qasshme për një audiencë të gjerë, me qëllim përmirësimin e ndërjegjësimit dhe mendimit kritik në komunitet.

## **2. Edukimi mbi Median e Informacionin në aktivitetet e programeve të organizatave rinore**

Në intervistat e zhvilluara me punëtorët e organizatave rinore, gjithashtu reflekton qasja pozitive ndaj edukimit medial në mesin e të rinjve në Kosovë. Punëtorët rinorë në Kosovë përcaktojnë angazhimin me të rinjtë si pjesë thelbësore të veprimtarive të tyre, me qëllim të fuqizimit dhe integritetit të tyre në proceset sociale dhe kulturore. Ata synojnë të zhvillojnë aftësitë e të rinjve nëpërmjet artit, kulturës dhe teknologjisë, duke u përpjekur të ndërtojnë një bazë të fortë për të ardhmen e tyre.

Nga përgjigjet në pyetjet e intervistës rezulton se edhe pse edukimi medial nuk është fokusi kryesor, punëtorët rinorë e konsiderojnë atë si një element kyç në formimin e një qytetari të informuar. Ata i kushtojnë vëmendje Edukimit mbi Medien dhe Informacionin nëpërmjet standardizimit të praktikave dhe ruajtjes së etikës në komunikim. Sa i përket zhvillimit të diskutimeve dhe aktiviteteve rreth fushës së EMI, fokusi i është dedikuar kujdesit indirekt, por planifikohet që në të ardhmen të përfshihet edhe edukimi medial si një temë qendrore në programet e organizatave të tyre.

Lidhur me vlerësimin e njohurive të rinjve, nga përgjigjet e tyre vihet në pah se punëtorët rinorë nuk japin një vlerësim të qartë për njohuritë e të rinjve rreth medie, duke preferuar të qëndrojnë neutralë dhe të mos bëjnë paragjykime mbi aftësitë e tyre.

Ndërkaq te fushat e fokusit dhe integritetit të EMI në aktivitetet e organizatave të tyre, ato përfshijnë artin dhe kulturën, ku edukimi medial integrohet nëpërmjet promovimit të përgjegjësisë dhe mendimit kritik ndaj informacionit dhe medie.



"Nëpërmjet artit dhe kulturës, ne ndërtojmë ura komunikimi dhe mirëkuptimi që i bëjnë të rinjtë jo vetëm konsumues, por edhe kritikë aktivë të informacionit që ata marrin çdo ditë" - **thuhet në përgjigjen e njërit nga të intervistuarit.**

Të rinjtë inkurajohen të zhvillojnë mendimin kritik rreth medieve e informacionit, veçanërisht nëpërmjet trajtimit të temave si paragjykimet dhe stereotipet në kontekstin e të drejtave të njeriut.

Sa i përket ndikimit të teknologjisë dhe rrjeteve sociale, nga përgjigjet rezulton se teknologjia dhe rrjetet sociale luajnë një rol të rëndësishëm në komunikimin dhe angazhimin e të rinjve, duke i bërë ata pjesëmarrës më aktivë në proceset shoqërore.

"E ardhmja e angazhimit rinor në mediat dhe teknologjinë përfshin një përjasje të re, duke e shndërruar secilin të ri në një agjent ndryshimi dhe inovacioni në fushën e informacionit" – **shkruan në përgjigjen e tij njëri nga të intervistuarit.**

Punëtorët rinorë janë në favor të përfshirjes së Edukimit mbi Median dhe Informacionin në shkolla. Përgjigjet e tyre shfaqin një mbështetje të fortë për përfshirjen e edukimit medial si lëndë obligative në shkolla, për të ndihmuar të rinjtë të bëhen më të ndërgjegjshëm dhe kritikë ndaj medieve.

"Ne duhet të sfidojmë perceptimet tradicionale dhe të bëjmë edukimin medial një prioritet, jo vetëm si një shtesë por si një nevojë thelbësore për të rinjtë tanë." - **thuhet në përgjigjen për nevojën e përfshirjes së edukimit medial në shkolla, në përgjigjen e njërit nga punëtorët rinorë.**

## **2. Edukimi mbi Median e Informacionin në aktivitetet e programeve të organizatave rinore**

Duke u nisur nga rezultatet e anketës me të rinjtë dhe intervistave me punëtorë të organizatave rinore, konsiderojmë se Edukimi mbi Median dhe Informacionin në radhë të parë është i lidhur ngushtë me politikat e arsimit të një vendi, prandaj në këtë pjesë të rezultateve të hulumtimit, trajtojmë rolin dhe përgjegjësinë e **MASHT** në edukimin formal, vlerësimet e ekspertëve kyç të fushës dhe angazhimin e organizatave ndërkombëtare.

**MASHT** në Kosovë, funksionon si trup kryesor rregullator për të gjitha iniciativat arsimore. **MASHT**-i është përgjegjës për krijimin e të gjitha strategjive dhe kurrikulave kombëtare të arsimit.

Sektori i arsimit në Kosovë është i ndarë në tri nivele: Arsimi i Përgjithshëm, Arsimi i Vazhduar dhe Profesional, dhe Niveli i Arsimit të Përgjithshëm i cili përfshin të gjithë arsimin formal nga arsimi parashkollor deri në arsimin e mesëm të lartë - një fazë kyçe për zhvillimin e të menduarit dhe të lexuarit kritik.

Në nivelin e arsimit të përgjithshëm, kurrikula përcaktohet nga MASHT përmes Agjencisë së Kosovës për Kurrikulum, Standarde dhe Vlerësim (**AKKSV**). Kjo e fundit është përgjegjëse për hartimin e Kornizës së Kurrikulës së Kosovës\* (**KKK**) dhe këshillimin e MASHT-it për kushtet e përgjithshme për kurrikulën bërthamë, si rezultat i së cilës janë themeluar të gjitha tekstet shkollore dhe qasjet e mësimdhënies.

Të menduarit dhe lexuarit kritik janë konceptet kryesore të përdorura në zhvillimin e një kornize dhe kurrikule të Edukimit mbi Medien dhe Informacionin.

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, e ka miratuar **kurrikulën bërthamë** në vitin 2016.

Te kurrikula bërthamë, Edukimi mbi Medien është i përfshirë si çështje ndërkurrikulare.

Çështjet ndërkurrikulare konceptohen si përmbajtje e rëndësishme kurrikulare që nuk i përkasin krejtësisht vetëm një lëndë apo fushe të kurrikulës ekskluzivisht mësimore, por që mësohet në disa lëndë.

Shembuj të zakonshëm janë edukimi për paqe, të drejtat e njeriut dhe edukata qytetare, çështjet gjinore, shkathtësitë e komunikimit, edukimi për zhvillim të qëndrueshëm, edukimi ndërkulturor etj.

Nga përmbajtja e kurrikulës në fjalë, vetëm një paragraf në formë përkufizimi i dedikohet Edukimit për Media dhe Informacionin.

“I referohet përdorimit të medieve për sigurimin e informacioneve të reja dhe të drejta, krijimin dhe përdorimin e informatave, komunikimin përmes medieve tradicionale dhe digjitale, kritikën ndaj medieve, gjuhën e medieve dhe ndikimin e saj në shoqëri, pritjet e qytetarëve nga mediet dhe përdorimit të drejtë dhe të sigurt të tyre etj. Çështja e edukimit për media përfshinë përmbajtjet lidhur me mediet tradicionale dhe digjitale, televizionin, radion, filmin, gazetën, revistat, internetin, fotografitë, reklamat dhe lojërat elektronike, etikën në media, etj.”, thuhet në kurrikulën bërthamë që përshkruan Edukimin për Media, që në fakt është përmbajtje e pamjaftueshme për të ndërtuar ndonjë koncept për problemet e reja në këtë fushë.

Avni Rexha, zëvendës drejtor i Departamentit për Arsim Parauniversitar në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, ka thënë se Edukimi medial është paraparë si lëndë zgjedhore e jo obligative, bazuar në Udhëzimin Administrativ të MASHT të vitit 2023, i cili përcakton dhe rregullon format e realizimit të kurrikulës me zgjedhje dhe procedurat për propozimin, përzgjedhjen dhe aprovimin e kurrikulës me zgjedhje, në pajtim me Kornizën Kurrikulare të Arsimit Parauniversitar.

Ekspertët e medias dhe të komunikimit të intervistuar për këtë hulumtim, konsiderojnë se lënda mbi Edukimin Medial dhe Informacionin do të duhej të futej si lëndë obligative në sistemin arsimor të Kosovës.

Alban Zeneli, profesor në Departamentin e Gazetarisë në Universitetin e Prishtinës, thotë se aktualisht edukimi për media është pjesë e kurrikulës bërthamë, që në praktikë i bie që mësimmshënësist mund të propozojnë këtë lëndë si lëndë zgjedhore në Drejtoritë Komunale të Arsimit. Por, me numrin e madh të përdoruesve të medieve sociale në Kosovë, lënda zgjedhore nuk mjafton. Të rinjtë e Kosovës e përdorin 6 herë më shumë median sociale se bashkëmoshatarët e tyre në vendet e Bashkimit Europian. Prandaj, sipas tij është koha e fundit që Ministria e Arsimit të vendos t'i rishikoj kurrikulat e shkollimit parauniversitar dhe të fus në këto planprograme si lëndë obligative Edukimin për Media dhe Informacionin.

Nga përmbajtja e kurrikulës në arsimin parauniversitar në Kosovë kuptohet që fëmijët që shkollohen në sistemin publik nuk kanë asnjë lëndë të veçantë obligative që i trajton çështjet e edukimit për median. Po ashtu, nëse analizohet lënda e Edukatës qytetare e cila ka përmbajtje për median, mësimet janë të tejkaluara dhe nuk trajtojnë në thelb çështjet e edukimit për median, konsideron Zeneli.

Imer Mushkolaj, kryetar i Këshillit të Medieve të Shkruara të Kosovës (**KMSHK**) e konsideron si nevojë urgjente, nevojën që edukimi medial të nis së mësuarit në shkolla. Gjithë shoqëria, por veçanërisht të rinjtë janë shumë të lidhur me teknologjinë dhe "bombardohen" çdo ditë nga përmbajtje të ndryshme mediale. Sa më herët që ata të dinë të bëjnë dallimin ndërmjet asaj që duhet konsumuar dhe asaj që nuk është e përshtatshme si informatë, aq më mirë, vlerëson Mushkolaj.

Ai gjithashtu e thekson faktin se kurrikula e lëndës së Edukimit mbi Median dhe Informacionin, duhet të harmonizohet në sistemin arsimor të Kosovës, duke marrë parasysh kontekstin lokal, mirëpo duke integruar praktikat më të mira arsimore evropiane.

Profesori i komunikimit në Universitetin për Biznes e Teknologji (**UBT**) Safet Zejnullahu, e konsideron shumë të rëndësishme futjen e lëndës së Edukimit Medial në shkolla, me harmonizimin e kurrikulës në sistemin arsimor të vendit me ato të vendeve perëndimore pasi konsideron se në vend të edukimit, publiku në Kosovë është goditur nga kaosi.

---

<https://masht.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/06/kurrikula-berthame-1-finale-2.pdf>

Intervistë me Avni Rexha

<https://masht.rks-gov.net/udhezim-administrativ-mashti-nr-11-2023-per-kurrikulen-me-zgjedhje-ne-arsimin-parauniversitar/>

Intervistë me Alban Zeneli, profesor në UP  
Ibid si në 11

Për dallim nga Mushkolaj e Zejnullahu, profesori Zeneli, potencon faktin se Bashkimi Evropian përveç rekomandimit që shkathtësitë e Edukimit për Media të jenë të domosdoshme nuk rekomandon forma të veçanta të zbatimit të kurrikulës për Edukimin mbi Median dhe Informacionin.

Për profesorin Zejnullahu, ndërkaq me qëllim të zbatimit sa më efektiv të kurrikulës është e domosdoshme përgatitja profesionale dhe trajnimi i mësimdhënësve për lëndën mbi Edukimit Medial dhe Informacionin.

Sipas të dhënave, Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (**SBASHK**) ka punuar në ngritjen e kapacitetit të mësimdhënësve në këtë fushë. Rreth tremijë mësimdhënës që shërbejnë në sistemin publik të shkollimit kanë përfunduar një modul bazik të Edukimit për Media. Përllogaritet se një numër rreth 10 për qind e mësimdhënësve kanë fituar shkathtësitë bazike të Edukimit për media përmes këtij trajnimi dhe do të mund të zbatonin lëndën në shkollat e tyre.

Mirëpo, Imer Mushkolaj mendon se në kohën kur përfshirja e edukimit medial në kurrikula mësimore është kthyer në domosdoshmëri, akterët përgjegjës e kanë humbur hapin dhe nuk ia kanë dalë t'iu përgjigjen kërkesave të kohës.

Në radhë të parë përgjegjëse janë institucionet sepse shoqëria civile, megjithatë, ka bërë punë në aspektin e edukimit joformal, vlerëson Mushkolaj.

Arben Hajredinaj, nga Sektori i Medias në organizatën **OSBE**, ka pohuar se investimi në edukim medial është kritik për të siguruar një shoqëri të informuar, kritike dhe përshtatëse për ndryshimet në mjedisin medial. Sipas tij, të paktën tri universitete publike tashmë e zbatojnë Edukimin mbi Medien dhe Informacionin në kurrikulat e tyre.

OSBE është njëra ndër organizatat e cila ka dhënë kontribut të madh në arsimin joformal, përmes aftësimit dhe trajnimit të mësimdhënësve në fushën e Edukimit mbi Median e Informacionin.

Përveç bashkëpunimit me Ministrinë e Arsimit nga viti **2016**, kjo organizatë ka zhvilluar një planprogram gjithëpërfshirës për studentët në universitetet publike në Kosovë. Që nga tetori i vitit **2019**, modulet nga planprogramet e zhvilluara nga OSBE ligjërohen në Departamentin e Gazetarisë në Universitetin e Prishtinës, duke përfshirë më shumë se **400** studentë për semestër.

Në vitet **2020** dhe **2022**, seminarët mbi edukimin medial dhe informativ u zgjeruan për të përfshirë mbi **1000** studentë aktual dhe të diplomuar në universitetet publike në Prishtinë, Prizren, Gjiilan, Pejë, Gjakovë, Mitrovicë e Jugut dhe Mitrovicë të Veriut. Seminarët i njohin studentët me edukimin medial dhe informacionin nga një këndvështrim akademik, kritik dhe praktik.

Sipas Haredinajt, bashkëpunimet e ngjashme me universitetet private në vitin **2023** janë vazhdimësi e përpjekjeve për futjen e Edukimit mbi Medien dhe Informacionin në sistemin e arsimit të lartë në Kosovë.

Vetëm gjatë këtij viti, kjo organizatë ka mbajtur dhe planifikuar të organizojë dhjeta punëtori për shkollat e mesme në rajonin e Prishtinës, si dhe për nxënës të shkollave fillore dhe të mesme nga rajone të ndryshme të Kosovës.

---

Intervistë me Imer Mushkolaj, kryetar i KMSHK  
Intervistë me Arben Haredinaj, misioni i OSBE –së në Kosovë  
Ibid si në 18  
Intervistë me Arben Hajredinaj, OSBE  
Ibid si në 20



Përveç këtyre punëtorive, përmes bashkëpunimit me festivalin ndërkombëtar të filmit dokumentar dhe të shkurtër, DokuFest, ka lehtësuar trajnimet për mësimdhënësit e shkollave të mesme dhe për të promovuar rëndësinë e edukimit medial dhe të informacionit, si dhe ka krijuar Bibliotekën Online të Mësimdhënësve e cila ofron filma dhe materiale didaktike që mund t'i ndihmojnë studentët të zhvillojnë njohuritë, aftësitë, qëndrimet dhe prirjet që janë thelbësore për një shoqëri demokratike.

OSBE gjithashtu ka organizuar një numër të konsiderueshëm të trajnimeve për edukimin medial dhe informativ për grupe të ndryshme si dhe ka realizuar projekte të cilat shërbejnë për ndërgjegjësimin për Edukimin mbi Mediat dhe Informacionin.

Për profesorin Safet Zejnullahu aktivitetet që organizohen për edukimin medial në arsimin joformal, janë të pamjaftueshme.

Si shembull ai merr organizimin e tryezave, për përmbajtjen e të cilave rrallë flitet jashtë sallës. Prandaj ai mendon se përkundër përpjekjeve e iniciativave të shumta, si në arsimin formal e jo formal, në Kosovë ka mungesë të Edukimit mbi Medien dhe Informacionin. Sherrin e mungesës së edukimit medial Kosova e ka "në derë" vlerëson Zejnullahu duke apeluar që të ndalet dëmi i mëtejshëm që mund të shkaktojë kjo mungesë. Ai madje bën thirrje që fillimisht të edukohet media, pastaj publiku.

Sepse publiku gëlltit çka t'i afrohet, ndërsa ato pak media serioze nuk gjejnë publik nëse ndjekin parimin profesional të raportimit. Propaganda e hapur, në dëm e rrezik për Kosovën gjen vend me bollëk në medien në shqip dhe shkon te publiku pa u përpunuar. Po kështu, lajmet një burimore e vrasin gazetarinë. E ç'orientojnë publikun. E bëjnë të besojë se ashtu duhet të jetë media, konkludon Zejnullahu. Ai thekson gjithashtu faktin se në vendet demokratike, i takon transmetuesit publik ta edukojë publikun.

Se ka mungesë të Edukimi medial në Kosovë, është i mendimit edhe Imer Mushkolaj nga **KMSHK**.

---

Together with Dokufest, our Media Section... - OSCE Mission in Kosovo | Facebook

Ibid si në 22

Intervista me Safet Zejnullahun, profesor në UBT

Ibid si në 24

Intervista me Imer Mushkolaj, kryetar i KMSHK

Sipas tij gjeneratat e reja po rriten pa pasur mundësi që të zhvillojnë mendimin kritik sa duhet dhe pa pasur mundësi të njohin mjedisin dinamik medial - dhe jo vetëm - në të cilin jetojnë. Zhvillimi teknologjik po ndodh vrullshëm dhe rrjedhimisht po rritet edhe nevoja për edukim medial që nga moshat më të hershme. Në mungesë të edukimit medial, të rinjtë - dhe jo vetëm ata - lehtë bien pre e dezinformatave dhe lajmeve të rreme, por edhe përmbajtjeve të tjera të papërshtatshme mediale, potencon Mushkolaj.

Zeneli ndërkaq, konsideron se njëra nga shkathtësitë më të mëdha të edukimit për media ka të bëjë me kuptimin e rolit, funksionit të medias në shoqëri dhe mundësisë së audiencës që të kuptoj llojet e përmbajtjeve mediale, duke i ndarë ato në kategori, e të ketë mendim kritik. Nga kjo pikëpamje, të rinjtë që kalojnë në shkollimin publik nuk i fitojnë këto shkathtësi dhe rrjedhimisht janë shumë të ekspozuar ndaj çrregullimit dhe manipulimit të informacionit.

Rreziqet e mungesës së edukimit medial sipas tij lidhen me sjelljet e njerëzve në sferën online si dhe sjelljet e tyre në përgjithësi që mund të manipulohen nëse bazohen në informacione të rreme, të manipuluar, etj. Rreziqet lidhen kryesisht me tri fusha; sigurinë, politikën dhe ekonominë. Në këto fusha ka rrezik më të madh që njerëzit që i bazojnë sjelljet e tyre në rrena, atëherë sjellja e tyre është e gabuar, që mund të drejtoj në protesta të dhunshme, kërcënime për sigurinë, orientim dhe vendime të gabuara politike, si dhe tu ndihmojnë dezinformuesve që të përfitojnë nga "puna" e tyre, konkludon Zeneli.

# PËRFUNDIMET

Edukimi mbi Median dhe Informacionin është i rëndësishëm në Kosovë, pasi bazuar në rezultatet e hulumtimit media është burimi kryesor i informacionit, dhe gjithashtu formon perceptimet që ndikojnë në krijimin e opinionit të rinjve mbi çështje të ndryshme sociale, politike, ekonomike, kulturore dhe të tjera.

Rezultatet gjithashtu nxjerrin në pah një interes të lartë dhe një angazhim aktiv të të rinjve në Kosovë ndaj edukimit medial.

Është e qartë se të rinjtë vlerësojnë dhe përdorin burime të ndryshme të informacionit, duke përfshirë rrjetet sociale dhe portalet online, për të qëndruar të informuar dhe kritikë ndaj lajmeve që konsumojnë. Edukimi mbi Median dhe Informacionin del të jetë thelbësor për të ndihmuar të rinjtë të identifikojnë dhe të luftojnë dezinformimin, si dhe për të zhvilluar aftësi kritike të mendimit dhe analizimit të përmbajtjeve mediatike.

Sa i përket përfshirjes së lëndës së Edukimit mbi Median dhe Informacionin në sistemin e arsimit të Kosovës, një debat i vazhdueshëm është zhvilluar në shoqërinë kosovare, në veçanti me rritjen e dezinformimit, propagandës e lajmeve të rreme e rrezikut që po kanoset nga Serbia dhe Rusia.

Rezultatet e hulumtimit tonë e bëjnë të qartë se duhet të ndërtohet një strategji kombëtare mes hisedarëve përgjegjës për politikën arsimore në Kosovë, që lënda mbi Edukimin mbi Median dhe Informacionin të futet si lëndë obligative në të gjitha nivelet e arsimit në Kosovë.

Ekspertët e intervistuar për këtë hulumtim e konsiderojnë si hap të vonuar këtë gjë, duke e konsideruar nevojë urgjente, pasi vlerësojnë se ka mungesë të edukimit medial në Kosovë. Ata gjithashtu akuzojnë për dështim dhe vonesa aktorët kompetencë në sferën e arsimit formal në Kosovë, duke theksuar se shoqëria civile ka bërë shumë më tepër për edukimin media sesa ata që janë përgjegjës për këtë çështje.

Ata i quajnë të pakta edhe aktivitetet e organizuara lidhur me këtë çështje, edhe pse organizata ndërkombëtare e lokale në Kosovë në vazhdimësi organizojnë trajnime, tryeza, seminare, fushata ndërgjegjësimi etj.

Një ide që duhet të shqyrtohet, të debatohet e të hulumtohet tutje është edukimi i medieive. Sipas ekspertëve të intervistuar, është i rëndësie të veçantë edukimi i medieive, para se të punohet në edukimin medial.

# REKOMANDIMET

Bazuar në gjetjet e hulumtimit nga anketa dhe intervistat primare dhe ato me shkrim, si dhe intervistat me ekspertët e medias e komunikimit, rekomandojmë:

Hartimin e një strategjie kombëtare për Edukimin mbi Medien dhe Informacionin.

Përfshirjen e Edukimit mbi Medien dhe Informacionin në kurrikulat e të gjitha niveleve të arsimit në Kosovë.

Edukimi mbi Median e Informacionin të bëhet lëndë obligative në shkolla për të siguruar që çdo nxënës të ketë qasje në mësimin dhe praktikën më të mira të medias.

Bashkëpunimi i ngushtë i shoqërisë civile, Universitetit të Prishtinës (**UP**), Ministrisë së Arsimit, Shkencës e Teknologjisë (**MASHT**) me qëllim të integritit të Edukimit mbi Medien dhe Informacionin në sistemin formal dhe joformal të arsimit për të siguruar një bazë të gjerë të njohurive për të rinjtë.

Organizimi i trajnimeve të specializuara nga organizatat ndërkombëtare e lokale dhe institucionet arsimore të cilat mund të ofrojnë trajnime të vazhdueshme për edukimin medial, të udhëhequra nga ekspertë të fushës.

Përdorimi i teknologjisë dhe rrjeteve sociale si mjet për të rritur ndërgjegjësimin dhe për të lehtësuar qasjen në informacion të besueshëm.

Organizimi i fushatave të ndërgjegjësimin.

Përmes organizimit të fushatave informuese që synojnë të rinjtë dhe grupet e tjera demografike për të nxitur mendimin kritikën dhe përgjegjshmërinë ndaj medieve.

Këto veprime do të ndihmojnë në ndërtimin e një shoqërie më të informuar dhe më të përgjegjshme, duke i bërë të rinjtë jo vetëm konsumatorë të medieve, por edhe pjesëmarrës aktivë dhe kritikë në dialogun shoqëror dhe demokratik.

## Shtojca 1

### PYETËSORI ME TË RINJ

1. Sa shpesh lexoni lajmet në ditë? A mendoni se është e rëndësishme të jeni të informuar për ngjarjet e fundit?
2. Cilat janë dy burimet kryesore të informacionit për ju? Përse preferoni ato burime?
3. A mund ta përshkruani me fjalë tuaja se çka kuptoni me dezinformim?
4. A zhvilloni ndonjëherë diskutime ose aktivitete që trajtojnë temat e edukimit medial në organizatën ku jeni vullnetar/e?
5. Si ndikon përdorimi i teknologjisë dhe rrjeteve sociale në punën tuaj vullnetare?
6. A duhet të futet edukimi medial si lëndë obligative në shkolla, në mbështetjen e të rinjve për të qenë më të ndërgjegjshëm dhe kritikë ndaj mediave dhe informacionit?
7. A keni ndonjë sugjerim për organizatat jo-qeveritare për të përmbushur më mirë rolin e tyre në edukimin medial të komunitetit?

# REFERENCAT

1. Intervistë me Imer Mushkolaj, kryetar i KMSHK, bërë më 04.04.2024
2. Intervistë me Avni Rexha, drejtor në MASHT, bërë më 03.04.2024
3. Intervistë me Alban Zeneli, profesor në Universitetin e Prishtinës, bërë më 29.04.2024
4. Intervistë me Safet Zejnullahu, profesor në Universitetin për Biznes dhe Teknologji, 01.04.2024
5. Intervistë me Arben Hajredinaj, sektori për media në misionin e OSBE-së në Kosovë, bërë më 05.04.2024

## Burimet nga interneti

<https://www.unesco.org/en/media-information-literacy>

<https://masht.rks-gov.net/>

Indep-

Ndërtimi-i-besimit-në-media-përmes-Edukimit-mbi-Median-dhe-Informacionin-2.pdf

[stikk.org/w-content/uploads/2019/11/STIKK\\_IK\\_Report\\_Internet\\_Penetration\\_V3-final-1.pdf](stikk.org/w-content/uploads/2019/11/STIKK_IK_Report_Internet_Penetration_V3-final-1.pdf)

<https://masht.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/06/kurrikula-berthame-1-finale-2.pdf>

<https://masht.rks-gov.net/udhezim-administrativ-mashti-nr-11-2023-per-kurrikulen-me-zgjedhje-ne-arsimin-parauniversitar/>

<https://www.sbashk-rks.org/index.php/lajme/2313-ka-perfunduar-me-sukses-trajnimi-per-tri-grupe-te-mesimdhenesve>

[Together with Dokufest, our Media Section... - OSCE Mission in Kosovo | Facebook](#)

[OSCE Mission expands the reach of youth trained on media and information literacy in Kosovo | OSCE](#)

[Media literacy workshop for youth Today... - OSCE Mission in Kosovo | Facebook](#)

[🌐... - OSCE – The Organization for Security and Co-operation in Europe | Facebook](#)

[Keeping up with digital world through media literacy skills | OSCE](#)

[From 20 to 22 March 2018, the OSCE... - OSCE Mission in Kosovo | Facebook](#)

[Misioni i OSBE-së nis projektin për edukim mediatik në shkollat e mesme të ulëta në Kosovë | OSCE](#)

[Facebook](#)

[Dokufest - It's been an eventful weekend for #Dokufest in light of... | Facebook](#)

[In the current digital era, media and... - OSCE Mission in Kosovo | Facebook](#)

Ky studim dhe hulumtim u financua nga:



**Co-funded by  
the European Union**



Ky projekt u mbështet nga:

**giz** Deutsche Gesellschaft  
für Internationale  
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH



**Internews**



**Akademie**

Ky program implementohet nga KosovaLive dhe është mundësuar nga SustainMedia, një projekt i GIZ (Gjermania e Madhe), i financuar nga Bashkimi Europian dhe Qeveria Gjermane.

